

FATOS KONGOLI
MISTERI I MJELLMËS
ROMAN

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

MISTERI I MJELLMËS

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Anrila Spahija

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-348-80-7

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

Çdo ngjashmëri me persona, mjedise dhe ngjarje reale është e rastit.
Gjithçka në këtë libër është prodhim i fantazisë.

~ Autori ~

Pjesa e parë

1.

Dikush trokiti lehtë në derë. Vetvetiu, inspektori Nevil Bardhi, një burrë i ri rreth të tridhjetave thirri “hyr”, në pritje që dera të hapej. Mirëpo dera nuk u hap. Pas pak trokitja u përsërit, kësaj here disi më fort, çka e bëri të mendonte se dikushi s’kishte dëgjuar gjë.

Për arsye sigurie, siç e kërkonin rregullat, dera e zyrës së tij, si shumica e dyerve të tjera të zyrave të asaj godine trekatëshe, një vilë e stilit të vjetër, - dikur pronë e një ish-oficeri të lartë të ushtrisë mbretërore, me çati gotike, ndërtuar qysh përpara Luftës së Dytë Botërore të shekullit të kaluar, - ishte e veshur nga brenda me një shtresë speciale, që edhe nëse vije veshin prapa saj, të mos dëgjoje asgjë ç’bëhej aty. Ky

modifikim i dyerve kishte ndodhur rreth njëzet vjet të shkuar, kur në mjediset e godinës, me destinacione nga më të ndryshmet në kohëra të ndryshme, ishte vendosur përfundimisht ajo që njihet si Drejtoria e Përgjithshme Krimeve të Rënda (DPKR).

Zoti Bardhi, i diplomuar për matematikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, ulej në atë zyrë prej pesë vjetësh, praktikisht me të përfunduar studimet. Ky fakt, domethënë diplomimi në një shkencë si matematika, në përputhje me një traditë shumëvjeçare të institucionit, kishte luajtur një rol jo të vogël që, qyshkur ishte student, ai të projektohej nga përzgjedhësit e zyrës së personelit si një kandidat i mundshëm për t'u rekrutuar. Kishin luajtur një rol jo të vogël edhe rrethana të tjera, disi më specifike, që pasqyroheshin hollësisht në dosjen e hapur për të nga zyra e plotfuqishme e rekrutimit.

Nëse do t'i krijohej mundësia t'i hidhte një sy kësaj dosjeje, inspektori Bardhi do të pësonte një zhgënjim të hidhur. Jo, sepse aty gjendeshin gjëra të pavërteta, shpifje e të tjera të kësaj natyre, përkundrazi. Gjithçka thuhej në atë dosje rreth tij ishte e saktë, për arsyen e thjeshtë se përpiluesi kërkonte nga informatorët vetëm të dhëna të vërteta. Por ai nuk do t'ia falte vetes faktin që, për vite me radhë në fakultet, paskej qenë i vëzhguar, në njëfarë mënyre i spiunuar, pa kuptuar asgjë. Si dhe faktin tjetër disi të papritur që, për mbushjen e dosjes në fjalë, veç një numri bashkëstudentësh, duke nisur nga një moment i

caktuar, kur ishte njohur me të e deri në përfundim të studimeve, duhej të kishte dhënë ndihmesën e saj edhe ish-e dashura!

Ndjesia që do t'i ngjallte fillimisht ajo dosje, po t'i binte në dorë, do të ishte kërshëria për të gjetur se kush ishte përpiluesi i saj. Ndoshta ndonjë person me të cilin i rastiste të shkëmbehej korridoreve të godinës, apo të ulej pranë tij në lokalin e katit përdhes, kur zbriste atje për kafe. Nëse do të qe e mundur ta zbulonte këtë, ai do ta përgëzonte hartuesin mbi të gjitha për diçka veçanërisht të goditur: kodin që kishte zgjedhur me një sens të hollë humori, për ta shënuar në kapakun e dosjes: “Hercule Poirot”.

Kjo hollësi do t'i jepte të kuptonte shumë gjëra. Meqë kishte qenë kurdoherë një tip i mbyllur, që në fëmijëri ai nuk ngatërrohej me të tjerët, i pëlqente të rrinte në hije dhe nuk ia lejonte vetes të ndante me askënd ndonjë mendim apo dëshirë të fshehur.

Natyra disi e çuditshme e fëmijës së tyre u kishte rënë në sy menjëherë prindërve të tij, nënës, mësuese kimie në një nga gjimnazet e kryeqytetit, dhe të atit, mjek otorinolog. Pas dyshimeve drithëruese se mos ndoshta i vogli, me gjasë ishte autik, dora-dorës, me kalimin e muajve ishin qetësuar të dy: u vërtetua se vogëlushi gëzonte shëndet mendor normal, si gjithë të tjerët, me ndryshimin se ai nuk reagoonte si gjithë të tjerët. Mirëpo prindërit e tij e përjetuan në mënyrë aq dramatike këtë fakt sa hoqën dorë nga ideja për të nisur një fëmijë të dytë. Kështu që Nevil Bardhi u

rrit si fëmijë i vetëm, me përparësitë e njohura të një fëmije të vetëm, por gjithnjë e më i mbyllur në botën e tij.

Djaloshi shkëlqente në mësim, sidomos në matematikë. Nga ana tjetër, në përfundim të gjimnazit, ai zotëronte mirë gjuhën angleze falë një prirjeje të lindur ndaj gjuhëve, por edhe sepse prindërit, krahas programit shkollor të gjimnazit, ishin kujdesur të pajtonin për të një mësues anglishteje privat, kushëri i tyre. Në njëfarë mënyre, ky i fundit luajti tërthorazi një rol në karrierën e inspektorit të ardhshëm.

Kushëriri, një tip me trup prej atleti, rreth të tridhjetave, e jepte këtë lëndë në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja të kryeqytetit dhe kishte pranuar të vihej në dispozicion të nxënësit të privilegjuar kryesisht për shkak të lidhjes familjare. Me këtë rast, për herë të parë inspektori i ardhshëm u njoh me një njeri, për të cilin zuri të ushqente simpati të veçantë dhe, gjithnjë heshturazi, ta imitonte. Për shembull, ai e adhuronte kushëririn për fizikun e përkryer, si nëpër filma. Këshilla që edhe ai ta përsoste fizikun e tij, i erdhi menjëherë: t'i jepte rëndësi fizkulturës, ushtrimeve të përditshme gjimnastikore, në veçanti atyre me shtangë. Nga kjo pikëpamje, sado që ai bënte çmos të vinte në jetë këshillat e kushëririn, në mbyllje të shkollës së mesme, nuk arriti të formonte trupin e ëndërruar prej atleti, si nëpër filma. Përkundrazi, arriti diçka tjetër shumë më të rëndësishme: të zbulonte prirjen e tij. Dhe kjo falë kushëririn.

Në prag të maturës, me mbërritjen e pushimeve të verës, kur ata e ndërprisnin edhe mësimin në shtëpi, si rregull dy herë në javë, të hënave dhe të enjteve, kushëriri, gllabërues i letërsisë policore, për arsye thjesht didaktike zgjodhi nga biblioteka e tij dhe i la si detyrë të orvatej të lexonte një libër të kësaj natyre, të një shkrimtareje angleze që ai e adhuronte: romanin “Vrasje në Orient-Ekspres” të Agata Kristit (Agatha Christie).

Nxënësi i zellshëm e zbatoi me përpikëri porosinë e kushëririt. Dhe u përpi prej tij me gjithë kuptimin e fjalës, aq sa gjatë verës nuk bëri gjë tjetër veçse lexoi dhe rilexoi pa u ngopur këtë roman, i mrekulluar nga protagonistin Hercule Poirot. Më pas ai lexoi edhe libra të tjerë të Agata Kristit, pati mundësi të shihte në televizor edhe seri filmash anglezë, ndërtuar mbi romanet e shkrimtares së famshme, i mrekulluar kësaj radhe nga një aktor i quajtur David Suchet, emër që iu ngulit në kujtesë për të mos e harruar kurrë, i cili luante nga filmi në film rolin e detektivit privat legjendar me origjinë belge, Hercule Poirot. Ky u bë menjëherë idhulli i tij dhe, qysh se mbaroi së lexuari për herë të parë gjatë asaj vere romanin “Vrasje në Orient-Ekspres”, zuri të sundohej nga një ëndërr e vetme: për të nuk mund të kishte të ardhme tjetër, përveçse të ndiqte shembullin e idhullit të tij Hercule Poirot, të bëhej detektiv.

Një dëshirë e fshehur, që për njëfarë kohe, nuk e ndau me askënd. Derisa rrethanat e sollën të njihej me një vajzë. Ai nuk ishte i pandjeshëm ndaj hireve femërore, por në përputhje me natyrën e tij të mbyllur,

siç u shmangej të tjerëve, u shmangej edhe vajzave. Për më tepër në kursin e tij të matematikës vajzat numëroheshin me gishtat e dorës dhe asnjëra prej tyre nuk e tërhiqte.

Kështu do të vazhdonte edhe më tej sikur të mos ndodhte diçka që nuk i shkonte nëpër mend: nga fillimi i të vitit të dytë të fakultetit atij ia vuri syrin një vajzë. Ajo nuk studionte për matematikë. Sapo kishte nisur të ndiqte në po atë fakultet degën biologji-kimi, në vitin e parë.

Marieta, kështu quhej vajza, ishte e bukur, sipas disave më e bukura e fakultetit dhe tërhoqi menjëherë vëmendjen e djemve. Një bionde me flokë të verdhë, natyrorë, jo të lyer, të gjatë deri poshtë supeve, të ndarë me vizë anash, ajo kishte sy të kaltër dhe dimërverë vishej me fustane të shkurtra, që nxirrnin në pah këmbët e saj. Këto, bashkë me gjinjtë gjithmonë të zbuluar disi bujarisht, ishin pika më e fortë e saj.

S'kaloi shumë kohë dhe mëtuesit u habitën kur vunë re se ajo po shihej gjithnjë e më shpesh në shoqërinë e një tipi të çuditshëm, në vitin e dytë të degës matematikë. Më të informuarit, që ndiqnin çdo lëvizje të vajzës nga mëngjesi në mbrëmje, që dinin gjithçka rreth saj, fjala vjen se ishte korçare dhe ndante një garsonierë diku, me një studente të mjekësisë, vinin dorën në zjarr se tipit të çuditshëm nuk i takonte asnjë meritë në këtë mes. Sipas tyre e vërteta qëndronte ndryshe. Vajza e lakmuar, që kishte zmbropsur jo pak mëtues ku e ku më interesantë, e kishte gjuajtur vetë tipin në fjalë.

Një mbrëmje ishin parë të dy të ngjiteshin te garsoniera ku banonte ajo, prej nga fatlumi qe larguar pas nja dy orësh.

Ec e merri vesh femrat, qenkej ankuar mëtuesi përgjues!

Po të kishte mundësi t'i hidhte një sy, pra, dosjes “Hercule Poirot”, inspektori Bardhi do ta kuptonte menjëherë se burimi kryesor i të dhënave që pasqyroheshin aty ishte Marieta. Ëndrrën e jetës për t'u bërë detektiv dhe gjithçka tjetër rreth këtij subjekti, ai ia kishte zbuluar vetëm asaj.

Më tej, zhgënjimi do të bëhej edhe më i hidhur kur të ndeshte po aty hollësira të pabesueshme. Për shembull, një nga tiparet me të cilat përshkruhej ai ishin frenezitë erotike. Partnerja M. A., kodi i zgjedhur për vajzën, dëshmonte se si mashkull, në pikëpamje seksuale, ai vërtet kishte një të metë, sepse prishej shpejt. Megjithatë po aq shpejt ishte në gjendje t'ia niste nga e para dhe nuk i shqitej asaj për rreth dy orë, aq sa zgjasnin seancat e tyre erotike. Këto hollësira absolutisht s'mund t'i dinte askush tjetër përveç Marietës, e vetmja vajzë me të cilën kishte pasur një marrëdhënie dashurie deri në përfundim të fakultetit.

Sigurisht, gjasat që dosja “Hercule Poirot” t' i binte në dorë, praktikisht ishin zero.

Pas trokitjes së dytë, më e fortë se e para, inspektori e la tryezën dhe vajti drejt derës. Gjëja e parë që i ra në sy: një zarf i formatit të madh, në ngjyrë kafe, i lënë nën derë. Vetvetiu vështroi në të dyja anët e

korridorit; personi që kishte trokitur ishte zhdukur. Atëherë ai u përkul, mori zarfin, mbi të cilin ishte shkruar me shkronja kapitale “Zotit Nevil Bardhi”, dhe u kthye pranë tryezës së punës, ku një copë herë mbeti në mëdyshje, pa e vendosur nëse duhej ta hapte zarfin, megjithëse duhej qartë, marrësi nuk mund të ishte askush tjetër përveç atij vetë. Mirëpo në këtë mes diçka nuk shkonte.

E pamundur që dërguesi të vinte nga jashtë, në hyrje të godinës një polic vigjilonte në një kabinë, ku depozitohej çdo korrespondencë, pa lejuar askënd të futej në institucion. Përndryshe i duhej të pranonte se prurësi duhej të ishte ndonjë person i brendshëm e kjo vetvetiu ngrinte pikëpyetje. Sepse, ç’ ishte nevoja ta linte zarfin tinëzisht poshtë derës e të zhdukej?

Më në fund ai e vendosi, hapi zarfin. Brenda tij gjendeshin dy zarfe të zakonshme dhe një copë pusullë. Në pusullë shkruhej:

“Lutem, nëse është e mundur, lexoni në fillim letrën në zarfin e shënjuar me numrin 1. Pastaj, gjithnjë nëse është e mundur, lexoni letrën e zarfit me numër 2”.

Vetëm kaq.

“Mirë, - mërmëriti ai, - si të urdhërojë zotëria juaj!” Nxori letrën nga zarfi me numër 1, i lënë enkas pa u mbyllur me pështymë apo në ndonjë mënyrë tjetër. Në krye lexoi mekanikisht:

“Tiranë, më 16.03.2002,
Inspektorit Sabit Kurti”.

Zoti Bardhi u befasua mirëfilli nga data, doemos, por më shumë nga emri i marrësit. Gjithsesi, vuri re se letra nuk ishte origjinale, dërguesi kishte parapëlqyer ta mbante këtë të fundit për vete dhe kishte nisur një fotokopje. Kjo nuk e pengoi zotin Bardhi të vërente se origjinali ishte shkruar jo me stilolaps, por me stilograf, praktikë gjithnjë e më e rrallë, me shkrim të rregullt, të qartë, do të quhej i bukur.

“I nderuari zotëri,

Në krye dëshiroj t’ju rrëfej një të vërtetë: për arsye që do të ishin të kuptueshme nga ana juaj, fillimisht më ngacmoi ideja të mos paraqitem se kush jam, qoftë edhe me ndonjë emër të rremë, as t’i firmos këto radhë. Në këtë rast letra do të quhej anonime, çka nuk më nderon, nuk është as në natyrën as në karakterin tim. Kështu që, si do ta shihni, e hodha poshtë këtë ide dhe identitetin tim do t’ju zbuloj dora-dorës.

Më lejoni tani të hyj në temë, t’ju shpjegoj arsyen, më saktë arsyet, përse vendosa ta shkruaj këtë letër. Dhe përse t’ju dërgoj pikërisht juve.

Po e nis nga e dyta. Ju, zoti Kurti, në sytë e mi jeni një person me integritet, sipas meje, pa dashur të ul vlerat e të tjerëve, personi më me integritet në institucionin ku punoni. Ndërsa arsyet që po ju shkruaj janë të shumta, lidhen me një dyshim të vjetër timin, që për të mos shpërdoruar kohën tuaj, për më tepër nga drujtja se gjithçka që do t’ju them nuk është e re për ju, do ta përmbledh fare shkurt.

Para nja dy muajsh, në agjencinë ku unë shërbeja deri atëherë, prej nga tashmë jam larguar, na mbërriti një informatë. Sipas informatës, kriminel i shumëkërkuar Y. Zh., autor i disa vrasjeve të bujshme kryesisht në kryeqytet, për të cilat duhet të jeni në dijeni, më në fund, ishte zbuluar se ku fshihej dhe jepej vendndodhja e tij, diku në periferi të kryeqytetit. Në krye të një grupi prej disa policësh, të armatosur rëndë, e rrethuan vendndodhjen në fshehtësi të plotë, një ditë rreth orës katër të mëngjesit, në kushtet e një të ftohti të acartë. Mirëpo vrasësin nuk e gjetëm. Gjithçka në apartamentin ku banonte ai dëshmonte se sapo ishte larguar, madje dukshëm për të na vënë në lojë, kishte lënë mbi një tryezë në kuzhinën e apartamentit, një shishe me uiski dhe dy gota.

Të them të drejtën, përballë kësaj pamjeje në atë kuzhinë ende të ngrohtë, që dëshmonte se ai kishte qenë i pranishëm, për t'ia mbathur prej andej me ngut, gjithsesi pa harruar të na linte një mesazh kuptimplotë, u ndjeva i poshtëruar. E qartë, në çastin e fundit të shumëkërkuarin dikush e kishte vënë në dijeni; operacioni ynë, i përgatitur prej muajsh të tërë, ishte dekonspiruar.

Dekonspirimi i operacioneve policore, nuk është ndonjë habi te ne. Herë pas here dyshime janë hedhur madje edhe ndaj zyrtarësh të lartë, të lidhur në një mënyrë apo një tjetër me botën e kriminit dhe unë nuk dua të zgjatem. Mirëpo rasti në fjalë më tronditi, më çekuilibroi, aq sa më çoi të jap dorëheqjen. Jo se ma kërkoi njeri, as për shkak të zhurmës që u bë rreth tij në të gjitha mediat, të shkruara dhe elektronike.

Këtë barrë turpi unë nuk mund ta mbaja mbi supe. Sa më shumë e bluaja me vete skandalin, aq më e fortë bëhej bindja ime se dekonspirimi buronte nga sferat më të larta të shërbimit ku punoja. Sepse, për operacionin dhe informatën lidhur me vrimën ku fshihej krimineli i rrezikshëm, fillimisht kishin dijeni vetëm dy persona: unë dhe eprori im. I bindur për këtë, pa mundur të bëja asnjë veprim, s'më mbeti gjë tjetër veç të jepja dorëheqjen.

Veprim i gabuar: keqdashësit e mi, përfituan nga rasti të përhapnin legjendën që më mbuloi me turp, sikur dekonspiruesi i operacionit kisha qenë pikërisht unë!

U pendova hidhur për këtë, por, kur e kuptova, mirëfilli që qe tepër vonë. Me veprimin tim, i sunduar nga emocione të çastit, unë dhashë kontribut në mjegullën rreth vrasësit Y. Zh. dhe porositësve të tij, sepse ai ka qenë thjesht një vrasës me pagesë, sipas meje vegël e një rrjeti mafioz brenda dhe jashtë vendit; pra, dhashë pa dashur kontributin tim, që kjo mjegull të bëhej më e dendur dhe emri im të damkoset.

Së fundi, arsyeja që vendosa t'ju shkruaj edhe juve për këtë incident nuk ka lidhje me përbaltjen time. Thjesht dëshiroj t'ju bëj të ditur një fakt: veç eprorit tim, për operacionin e dekonspiruar ka pasur dijeni edhe drejtori i DPKR-së, domethënë eprori juaj më i lartë. Bashkëpunimi i ngushtë midis dy shërbimeve tona në raste të tilla ka qenë dhe mbetet një praktikë e detyrueshme.

Me shumë respekt për ju,
Besim Shkëmbi.”

Inspektori mbeti një copë herë me letrën në dorë, me sytë të ngulitur te data kur ajo ishte shkruar: 16.03.2002. Meqë atë ditë kalendari mbi tryezën e tij të punës shënonte datën 05.04.2018, një llogari e thjeshtë aritmetike i dha të kuptonte se ajo ishte formuluar plot gjashtëmbëdhjetë vjet të shkuar.

I përfshirë nga një lloj kureshtjeje, ai hapi zarfin e shënuar me numrin 2, i lënë enkas gjithashtu pa u mbyllur me pështymë apo me ndonjë mënyrë tjetër.

“Zoti Bardhi,

Nëse keni pasur kureshtje ta çoni deri në fund letrën e zarfit pararendës, uroj të keni durim ta lexoni deri në fund edhe këtë letër, të shkruar prej meje.

Kush jam unë? S’ka pikë rëndësie! Po ashtu s’kanë rëndësi as rrethanat që mundësuan të më binte në dorë letra në fjalë. E rëndësishme është të theksoj se autori i saj nuk e nisi kurrë në destinacion, e mbajti për vete, duket arsye të forta ia ndryshuan mendjen, dhe tani, pas plot gjashtëmbëdhjetë vjetësh, siç besoj ta keni konstatuar edhe ju, ajo vjen si një klithmë në shkretëtirë. Që autori i saj e ka konsideruar atë si klithmë zemërimi, jam e sigurt.

Siç jam e sigurt që klithma e tij do të binte në vesh të shurdhër, si duhet të ketë qenë i sigurt për këtë edhe vetë autori.

Tani me të drejtë ju mund të shtroni pyetjen: përse po ju drejtohem juve, përse ju dërgoj një letër të shkruar gjashtëmbëdhjetë vjet të shkuar, kur edhe unë, edhe ju, kemi qenë adoleshentë dhe jetonim

në një botë tjetër? Për më tepër kur protagonistët, domethënë hartuesi i letrës dhe marrësi i saj i munguar, inspektori Sabit Kurti, nuk janë më në këtë botë? Kryesorja: çfarë kërkoj nga ju?

Asgjë. Unë thjesht kam dëshirë t'ju njoh, megjithëse ç'është e vërteta unë ju njoh prej vitesh. Dhe prej vitesh kam pasur dëshirë t'ju njoh. E kam fjalën nga shumë afër...

Shpresoj ta merrni me mend ç'dua të them, kjo ka qenë dhe mbetet një kureshtje, që më ngacmon edhe sot. Nuk e merrni me mend? Mirë, në këtë rast jam e detyruar t'ju zbuloj ndonjë hollësi të periudhës studentore, kur ju ngjallnit zilinë e të gjithë djemve, si i preferuari i një biondine, biondina e biokimisë, siç e quanin. Kam përshtypjen, ndoshta të gabuar, se ajo ka qenë e vetmja vajzë me të cilën keni fjetur gjatë viteve të fakultetit. Në të kundërt, për këtë jam e sigurt, ju nuk keni qenë i vetmi mashkull me të cilin ajo flinte ato kohë dhe ka shumë të ngjarë që këtë hollësi të mos e dini.

Midis djemve që ajo shkonte po përmend edhe ish-të dashurin tim. Ne të dy, domethënë unë dhe ish-i dashuri im, studionim në të njëjtin fakultet si edhe ju, në një degë të ndryshme nga matematika, kështu që ndodhte t'ju shihja vetëm korridoreve të godinës së fakultetit. E dija që edhe ish-i dashuri im shkonte me biondinën tuaj, por s'kam qenë xhelozie, si nuk shfaqte as ai shenja xhelozie ndaj meje për ndonjë tekë timen të ngjashme. Ishim, si të thuash, të pavarur nga njëri-tjetri dhe në këtë pikë nuk e ngacmonim njëri-tjetrin,

e kjo e bënte më të këndshme marrëdhënien tonë të pakushtëzuar. Kësaj marrëveshjeje të heshtur ai nuk iu përmbajt vetëm në një rast, e ky rast ka të bëjë me ju.

Një ditë, në dhomën e një hoteli ku shkonim, tek rrinim shtrirë mbi krevat, befas ai ia këputi një të qeshure.

- Ç'pate? - e pyeta.

- Asgjë, - ma ktheu ai.

Dhe shtoi:

- Druaj se mund të bëhesh xheloze, s'dua të të mërzis...

- Lëre, - këmbëngula unë, - më thuaj, të paktën të qesh edhe unë.

Puna ishte kështu: para nja dy netësh ai paskej fjetur me biondinën e biokimisë në apartamentin ku ajo banonte, kuptohet, në të njëjtin shtrat ku flinte edhe me ju. Mirëpo mbrëmjet që kalonte me ju duhet të kenë qenë shumë të ndryshme nga ato me ish-të dashurin tim. Sepse ky i fundit, veç të tjerash, përdorte edhe alkool, ndërsa biondina juaj, edhe pse jopërdoruese, nuk e përbuzte atë, përkundrazi. Ndoshta nën efektin e uiskit, që ish-i dashuri im kujdesej të merrte me vete sa herë shkonte tek ajo, i kishte dhënë të drejtën vetes ta pyeste se si ishte e mundur që flinte rregullisht me një tip, që disa ziliqarë, e cilësonin me nofkën 'maska e padepërtueshme'.

Nuk e di nëse ju kishte rënë në vesh nofka 'maska e padepërtueshme', por biondja e kishte shtangur ish-të dashurin tim me përgjigjen e saj. Po

t'i besojë biondes, Maska, domethënë ju, qenkej tipi më i këndshëm që paskej njohur: interesant, aspak i mërzitshëm, ndonëse nuk përdorte alkool. Kënaqësinë e alkoolit ajo e ndante me të tjerë, meshkuj lehtësisht të lexueshëm. Maska, domethënë ju, ishte i veçantë pikërisht për shkak të maskës, i palexueshëm dhe biondja, pa ndërmjetësinë e alkoolit, ia kishte dalë të depërtonte për të parë se çfarë fshihej përtej saj.

E para, ai ishte një student i shkëlqyer, pa vese. Vesi i tij i vetëm, nëse do të mund të quhej kështu, ishte leximi i librave policorë. Dhe lidhur me këtë, ëndrra e jetës së tij: të bëhej detektiv privat. Heroi dhe idhulli i tij qenkej personazhi kryesor i romaneve të shkrimtares angleze Agata Kristi, i quajtur Hercule Poirot. Të them të drejtën, kishte pohuar biondja, unë nuk e kisha dëgjuar ndonjëherë as emrin e Agata Kristit, as të detektivit Hercule Poirot, që t'i mbaja mend m'u desh t'i shënoja në një bllok.

Sidoqoftë, nuk ishte kjo hollësi që më mbeti në mendje. Diçka tjetër më turbullonte në thellësi të qenies tek dëgjoja nga ish-i dashuri im përshkrimin e biondes për Maskën: frenezia seksuale e këtij të fundit. Sipas biondes ai vërtet kishte një të metë, prishej shpejt, por po aq shpejt vinte sërish në formë. Nuk ia kthente shpinën partneres, si bëjnë zakonisht meshkujt pasi harxhohen. Ai nuk shqitej për rreth dy orë, aq sa partnerja shterohej dhe ia kthente shpinën e para.

Dëshira për t'ju njohur 'nga shumë afër', më ka lindur fill pasi ish-i dashuri im, duke m'i rrëfyer këto

intimitete me një lloj humori, për të mos thënë me një lloj talljeje, pa dashur zgjoi tek unë kureshtjen për të fjetur me ju. Sa herë rastiste të kryqëzoheshim në mjediset e fakultetit, bëja çmos t'ju bija në sy, të tërhiqja vëmendjen tuaj. Pa sukses, biondja ju kishte përpirë të tërin...”

Për një çast, ai e ndërpreu leximin. Përpjekja të rikthehej mbrapsht, në vitet studentore, të rrëmonte kujtesën për të gjetur ndonjë fytyrë vajze, që të mund ta çonte tek e panjohura, doli e kotë.

“Kam përshtypjen se u zgjata dhe ndoshta ju kam mërzhitur, - vazhdoi ai leximin e letrës. - Nuk e di se çfarë do të mendonit nëse jua pohoj sërish dëshirën time të vjetër, por tani kam arsye që të ngurroj ta hedh këtë hap.

Ju, zoti Bardhi, keni arritur gjithçka. Nuk e kam fjalën për faktin se uleni çdo ditë në një karrige, në një zyrë ku përpara jush, veç të tjerëve, është ulur edhe i ndjeri Sabit Kurti që, siç duhet ta dini, u largua nga kjo botë i zhgënjyer. Mbi të gjitha ju keni realizuar, ose kujtoni se keni realizuar, ëndrrën tuaj për t'u bërë një lloj detektivi, nën shembullin e heroit tuaj të parapëlqyer, Hercule Poirot. Aktualisht ju zotëroni një apartament, në katin e tretë të një pallati pranë qendrës së kryeqytetit, ku mendoni se mund të ushtroni profesionin e detektivit privat.

Me lejoni t'ju vë në dukje lidhur me këtë se ju shihni një ëndërr me sy hapur. Sipas meje, prej shumë

kohësh ju keni parë një ëndërr me sy hapur, keni jetuar jashtë realitetit, e keni ushqyer veten me një utopi. Në mjedisin tonë, profesioni i detektivit të mirëfilltë privat, e përsëris, të mirëfilltë, është i pamundur. Kam një përshtypje të fortë se ndërkaq, në institucionin ku ju kanë rekrutuar për të shërbyer jo si detektiv privat, edhe ju vetë duhet ta keni kuptuar këtë. Ndoshta ngushëlloheni me idenë se pasionin tuaj mund ta ushtroni paralelisht dhe pavarësisht funksionit që kryeni në institucionin ku shërbeni. Kjo do të ishte një tjetër utopi. Sepse, duke qenë rrogëtar ju jeni i lidhur, do t'i shërbeni detyrimisht interesave të atij që ju paguan. Dhe se kush ju paguan, ju e dini mirë.

Më ka rënë në sy, për shembull se, kushdo që do të dojë të vijë tek apartamenti juaj - studio, nuk do të shohë gjëkund, as në hyrje të pallatit, as në derën e apartamentit, ndonjë tabelë ku të figurojë emri juaj, e aq më pak fjalët shoqëruese 'detektiv privat'. Arsyeja: në mjedisin tonë ky profesion, edhe nëse në rastin më të mirë mund të ushtrohet ilegalisht, nuk njihet me ligj dhe askujt nuk i intereson të njihet, pra nuk lëshohet licencë, thënë shqip lejë për ushtrimin e tij. Sepse një detektiv i përkushtuar privat, kureshtar e i pavarur, rrezik të guxonte të shkonte aq thellë, sa të mund të trondiste themele.

Heroi juaj Hercule Poirot nuk ishte rrogëtar i askujt. Prandaj, që të ndiqni ëndrrën tuaj, gjëja e parë që duhet të bëni është të dilni i pavarur dhe ju e kuptoni se çfarë dua të them. Por ju nuk mund ta bëni këtë.

Një këshillë miqësore: çdo përpjekje juaja për të rënë në gjurmët e mia, do të ishte e kotë. Për t'ju kursyer këto përpjekje, jam kujdesur të mos lë gjurmë gishtërinjsh në asnjërin nga zarfet, në asnjërën nga letrat. Në çdo laborator që t'i çoni, s'do të mund të gjeni asnjë gjurmë të ADN-së sime.

Dhe hapni sytë! Nuk do të doja të pësonit zhgënjimet e të paharruarit Sabit Kurti që është ulur përpara jush në po atë zyrë, në po atë karrige, ku aktualisht jeni ulur ju.

Sa më sipër, ma bën të pamundur realizimin e kureshtjes sime të vjetër ndaj jush, që më ngacmon po aq fort edhe sot e kësaj dite. Për këtë më vjen keq. Po ku ta dish? Si thuhet, *never say never!*

Së fundi një sugjerim: idhulli juaj Hercule Poirot, me ç'kam lexuar, ishte i famshëm gjithashtu për mustaqet e tij legjendare. Do të ishte e udhës që nën shembullin e tij të mbani edhe ju mustaqe të ngjashme, kjo do ta bënte më interesante dhe më bindëse pamjen tuaj prej detektivi!”

2.

Zoti Bardhi nuk mundi të mos vinte buzën në gaz, e panjohura kishte veç të tjerash një sens humori për t'u admiruar. Aty për aty i la letrat mënjanë, mori zarfin e madh ku shënohej me shkronja kapitale emri i tij dhe vajti tek ashensori, i montuar para pak kohësh, në kuadrin e modifikimeve të godinës. Kjo e fundit ishte trekatëshe, por me kate aq të larta sa praktikisht barazohej me një ngrehinë bashkëkohore katër-pesëkatëshe.

Ai nuk e kuptoi as vetë përse atë ditë zgjodhi të përdorte pikërisht ashensorin dhe jo shkallët, kabina e ngushtë ku mezi qëndronin dy persona të zinte

frymën. Sidoqoftë, me zarfin në dorë, u gjend te sporteli i kabinës së policit të shërbimit.

- Më thuaj, - e pyeti policin, i cili u ngrit në këmbë, - a është paraqitur sot te ti dikush me këtë zarf?

Tjetri iu përgjigj “po”.

Dhe shtoi:

- Ishte një zonjë apo zonjushë... Më tha se në këtë zarf kishte diçka për ju, që e prisnit me urgjencë. Ma la në dorë dhe u largua.

- Si ishte zonja, apo zonjusha? - e pyeti ai.

- Si t’ju them zotëri, - qeshi polici me një lloj nënkuptimi. - Një grua e bukur, do të thosha.

- Mirë, - ia preu shkurt ai, - kush e solli tek unë këtë zarf?

- Unë jua solla zotëri, ajo zonja apo zonjusha m’u lut t’jua sillja sa më shpejt. Dhe unë jua solla pa humbur asnjë sekondë.

- Po pse e le poshtë derës, pse nuk prite të ma jepje në dorë?

- S’më priste puna zotëri, - u shfajësua polici, - për ato pak minuta që u ngjita te ju lashë në kabinë një kolegun tim, që zakonisht qëndron te kati i dytë... Edhe kjo nuk më lejohej... duhej të kthehesha sa më shpejt... e bëra vetëm për ju...

Inspektori nuk e zgjati. E falënderoi policin dhe nuk i mbeti gjë tjetër veç të kthehej në zyrën e tij, kësaj radhe duke përdorur shkallët. Me të zënë vend pranë tryezës së punës, iu kthye sërish letrave. Pasi i rilexoi, i futi në zarfet përkatëse, këto të fundit në zarfin e madh, të madhin e kyçi në kasafortë, veprime

që i kreu në mënyrë gati mekanike, tërë përkujdesje. Si të donte të përqendrohej, të kapte domethënien e gjithçkaje. Dhe pashmangshëm e ngacmuan një varg pikëpyetjesh. E para, çfarë qëllimi ndiqte e panjohura duke ia dërguar këto letra atij? Përse pikërisht atij? Nga dëshira që, siç thoshte ajo, të njiheshin nga shumë afër?

U detyrua të pranonte se pavarësisht synimeve të saj, tjetra ia kishte dalë në një pikë: ta shpërqendronte. Qoftë dhe vetëm me keqardhjen që zuri ta brente për çka e panjohura i komunikonte me një cinizëm tipik femëror ndaj ish-të dashurës së tij të viteve të fakultetit.

Deri në mbyllje të orarit zyrtar mendja i mbeti po aty. Nuk mund ta pranonte idenë se Marieta, vajza e parë dhe e vetme me të cilën ishte dashuruar mirëfilli ndonjëherë, paskej qenë e paskrupullt, qenkej tallur aq mizorisht me të. Mirëpo argumentet e së panjohurës ishin kokëforta. Në ato çaste, i zhgënjyer keq, ai nuk do të ngurronte t'i jepte asaj një shuplakë.

Veprim i dëshpëruar, doemos! I jepte apo nuk i jepte së panjohurës një shuplakë, e vërteta mbetej po ajo: qenkej treguar naiv, për të mos thënë sylesh. Ai s'mund t'ia falte vetes që për vite me radhë Marieta e paskej tërhequr për hunde, si lolo.

Tek përpëlitej kështu në dëshpërimin e tij, befas e ngacmoi një dyshim. Mos vallë, në mënyrën e saj, edhe e panjohura ndiqte pikërisht këtë synim, ta tërhiqte për hunde, si lolo?

Ai mbeti për disa çaste si i ngrirë. Pastaj ia doli ta mbliidhte veten dhe sajoi një buzëqeshje.

- Mirë, pra, - mërmëriti, - edhe unë do të kisha dëshirë t'ju njihja nga shumë afër... Jam i një mendjeje me ju, *never say never!*

Dhe vendosi ta quante me një emër. Vrau kokën jo pak për të gjetur një emër të përshtatshëm, derisa, më në fund, e quajti Mjellma. Ky emër, me diçka të mistershme dhe romantike, - “Liçeni i Mjellmave” i Çajkovskit, - përputhej më së miri me përfytyrimin e tij për të panjohurën.

Rreth njëzet minuta më vonë, ai e ndaloi makinën e tij, një “Ford” ngjyrë blu, në një parking pranë pallatit ku banonte. Hyrja e parkingut gjendej buzë rrugës automobilistike dhe mund të futeshe vetëm pasi roja të ngrinte traun. Prej andej, nja dhjetë minuta të tjerë, më vonë, u ndodh në apartamentin e tij studio. Tek rrotullonte çelësin në bravë, gjithnjë nën pushtetin e ngacmimit të së panjohurës, u ndie i sigurt: ajo duhej të ishte ngjitur deri atje.

“Ka qëndruar përpara derës, - tha me vete, - në një çast kur unë s’duhet të kem qenë i pranishëm. Po ndoshta mund të kem qenë edhe brenda. Në këtë rast ka të ngjarë të ketë pasur një yshtje për të trokitur, e bindur se unë do t’ia hapja derën, duke menduar se do ta merrja për ndonjë kliente që vinte të kërkonte ndihmën time për ndonjë problem...”

“E ke shumë gabim, - e vazhdoi arsyetimin kur u fut në apartament dhe zuri vend në mjedisin e hollit,

kësaj here duke iu drejtuar Mjellmës, sikur kjo e fundit të ndodhej aty, e ulur në njërin nga kolltukët. - Ta përsëris, e ke shumë gabim kur mendon se nuk ka nga ata apo ato që kanë nevojë për shërbimet e mia. Më së shumti janë meshkuj, që kërkojnë prej meje të gjurmoj veprimet e bashkëshorteve apo dashnoreve. Klientet femra janë më të pakta, duket këto nuk e kanë fort problem të gjurmojnë partnerët e tyre, shqetësimi kryesor i tyre zakonisht është të mos jenë të gjurmuara dhe më lutem të verifikoj nëse janë apo nuk janë të gjurmuara...”

“Na mbushe mendjen”, e ndërpreu tjetra.

Dhe shtoi:

“Ti e di mirë, këto që po thua janë broçkulla. Dhe, sido që të jetë, edhe po t’i pranoj si të vërteta, më keq për ty! Me sa di, i famshmi Hercule Poirot merrte përsipër vetëm çështje që lidheshin me krime të rënda, me zbulimin e vrasësve. Historitë me dashuriçka dhe tradhti bashkëshortore nuk i interesonin, ai nuk pranonte ta ulte veten deri në këtë nivel!”.

Inspektori u zhyt në kolltuk. Në këtë pikë Mjellma kishte të drejtë. Një copë herë qëndroi me sytë mbyllur, derisa nxori celularin dhe formoi një thirrje. Në fillim nga ana tjetër nuk mori përgjigje, madje mbërriti një çast kur telefoni iu mbyll. E qartë, ana tjetër nuk dëshironte të fliste me të, çka nuk i erdhi dhe aq e papritur.

Nja dhjetë minuta më vonë ai e përsëriti thirrjen dhe në anën tjetër telefoni iu mbyll sërish. Këtë lojë

e përsëriti disa herë, çdo dhjetë minuta, derisa, më në fund, këmbëngulja e tij u shpërblye.

- Çfarë do?! - i mbërriti një zë femëror, dukshëm i pakënaqur.

- Kam një nevojë absolute të të shoh, - ia ktheu ai, - ke të drejtë të më mbash mëri, por të lutem, ashtu e kam një hall!

Në anën tjetër pasoi një heshtje e gjatë.

- Ti nuk ke asnjë hall, së paku nga ato që mund t'i ndash me mua, - vërejti bashkëfolësja.

- Jo, - ia ktheu ai, - mos u sill e paarsyeshme kur nuk je e tillë. Dua të të them diçka me rëndësi!

- Nuk mund të ma thuash në telefon atë gjënë me rëndësi, pa qenë e nevojshme të shihemi?

- Jo pra, - këmbënguli ai, - nuk është subjekt për telefon...

Në anën tjetër pasoi sërish një heshtje e gjatë.

- Nëse do ta dish, - foli bashkëbiseduesja me një ton më të zbutur, - sot kam qenë gjithë ditën me humor të keq. Ti, me sa shoh, qenke plot humor... Atëherë e provojmë, ose ti të ndreqësh humorin tim, ose unë të prish tëndin.

- Bukur, - ia ktheu ai, - po sikur të darkonim bashkë sonte?

Tjetra ngurroi për një çast.

- Mirë, - iu përgjigj, - sonte jam e lirë.

- Të vij te ti të të marr rreth orës tetë?

- S'është nevoja të vish tek unë, më thuaj ku të shihemi.

- Nuk besoj se mund të ketë vend më të përshtatshëm sesa restoranti i hotelit “Kondor”, si thua?

- Mirë, - iu përgjigj tjetra dhe mbylli telefonin.

Vetvetiu ai i hodhi një vështrim orës. Akrepat shënonin gjashtë e dhjetë minuta. Inspektori llogariti se deri në orën tetë, kur i duhej të gjendej të hoteli “Kondor”, i mbetej një kohë e mjaftueshme për t’iu përgatitur takimit të mbrëmjes e si fillim të bënte një banjë. Nën dush, nuk e pati në dorë të mos vazhdonte bisedën e ndërprerë me Mjellmën.

“Sapo fola në telefon me Gentën... Të lutem, bëhu serioze tani, mos më thuaj se nuk e di kush është Genta! Megjithatë disa hollësira vërtet mund të mos i dish dhe s’duhet t’i dish. Për shembull kur, ku dhe në ç’rrethana e kam njohur. Nuk je kureshtarë t’i mësosh? Vështirë ta besoj!

“Ndodhi nja dy vite të shkuara, në mbrëmjen e Vitit të Ri 2016. Bashkë me kolege e kolegë beqarë të DPKR-së, tri vajza e tre djem, kishim vajtur të festonim në restorantin e hotelit ‘Kondor’. Koleget dhe kolegët e mi i lejonin vetes të pinin, e natyrshme për atë natë, dhe nuk linin radhë pa kërcyer nën ritmet e një orkestre. Në atë hare, i vetmi që nuk pinte isha unë. Dhe kërceja më të rrallë, kur ndonjëra nga koleget këmbëngulte të vallëzoja me të, por askujt nuk i bënte përshtypje sjellja ime, ata më njihnin, nuk më ngacmonin. Për më tepër s’ma kishin ngenë, shihnin qejfin e tyre, kështu që unë zbavitesha thjesht duke i kullotur sytë nëpër sallë.

“Zbulimin e asaj mbrëmjeje e bëra afër mesit të natës, kur mjedisi ishte tepër i ndezur dhe të gjithë prisnin çastin e ndërrimit të viteve. Atëherë, pak tryeza më tutje, sytë më zunë një fytyrë do të thosha familjare për mua dhe u habita sesi nuk e kisha vënë re. Ishte një bionde, me flokë të shtrirë që i vareshin poshtë supeve dhe në fillim mbeta pa frymë: m’u duk si Marieta.

“S’është ndonjë e re për ty të të pohoj se kisha qenë marrëzisht i dashuruar pas Marietës dhe tek shihja bionden pak më tutje ndjeva se vazhdoja të isha ende i dashuruar. E pamundur të mblidhja veten, t’i shpëtoja një yshtjeje që më shtynte t’i mbaja sytë tërë kohën te biondja, derisa s’di sesi, vështrimet tona u kryqëzuan.

“Unë iu shmanga. Disa sekonda më vonë iu ktheva sërish, por kësaj radhe rashë në kurthin e saj: ajo po më mbante të mbërthyer.

“Më pas Genta më pohoi se kishte pësuar atë që francezët e quajnë ‘coup de fudre’. Nuk dija dhe nuk di frëngjisht. I kërkova të ma shpjegonte kuptimin e kësaj shprehjeje dhe i rashë në të se ashtu si unë në atë çast, edhe ajo paskej pësuar atë që në shqip quhet dashuri me shikimin e parë.

“U ngrita, vajta drejt tryezës ku ajo po festonte me miq të saj, e ftova për vallëzim. Çasti i ndërrimit të viteve na gjeti në sallë, në krah të njëri-tjetrit dhe kur u mbyllën dritat m’u duk e natyrshme t’i jepja një të puthur. Kur dritat u hapën ne vazhduam të putheshim dhe e gjithë salla në eufori, duartrokiti. Arsyen nuk e

di, por mendova, si kishte menduar edhe Genta, se të pranishmit duartrokitën puthjen tonë.

“Unë nuk kisha pirë asnjë gotë. Nuk dua të mendoj se sjellja e saj e shpenguar u ndikua nga fakti që, si munda të vëreja, ajo kishte marrë doza jo të vogla alkooli.

‘Genta’, më pëshpëriti në vesh, tek rrinim ende në mes të sallës, në sytë e të gjithëve.

‘Nevil’, i pëshpërita edhe unë në vesh.

‘Unë kam pirë ca, ndërsa ti s’më dukesh të kesh pirë dhe aq’, vërejti.

‘Tani ndihem i dehur tapë’, ia ktheva.

‘Ç’do të bëjmë, - më pyeti, - këtu do të rrimë?’

‘Pa e parë të nevojshme të shkonim të shpjegoheshim me miqtë tanë, që me siguri po na shihnin, u larguam nga salla dhe vajtëm te gardëroba. Atëherë vura re se ajo mbante veshur një fustan të gjatë, në ngjyrë të kuqe, ngjitur pas trupit, mbi të cilin veshi një pallto po aq të gjatë, të zezë. Unë tërhoqa xhupin tim prej lëkure, ngjyrë kafe.

‘Po tani’, e pyeta, pa ditur ç’të thosha tjetër.

‘Më vjen keq, - tha ajo, - erdha këtu me një shoqen time, me makinën e saj, pra jam pa makinë.’

‘Mos ki hall për këtë, - ia ktheva. - Ç’do të bëjmë, shkojmë në ndonjë lokal tjetër?’

‘Jo, - m’u përgjigj, - tani dua të kthehem në shtëpi.’

‘Vajtëm te parkingu i hotelit. Ajo parapëlqeu të më priste jashtë, në hyrje. Më tej, tek vozisja ngadalë drejt saj, vura re se po fliste në telefon me dikë dhe e ndërpreu bisedën sapo iu afrova.

‘Me prindërit jeton?’, e pyeta kur zuri vend në makinë.

‘Ajo ma mbylli gojën me kundërpyetjen:

‘Po ti, me prindërit vazhdon të jetosh?’

‘Nja pesëmbëdhjetë minuta më vonë mbërritëm pranë pallatit ku banonte ajo, në një apartament në katin e katërt. Gjatë këtyre pesëmbëdhjetë minutave mësuam një varg hollësirash për njëri-tjetrin. Ajo kishte studiuar për drejtësi. Prej dy vjetësh, pas vdekjes së papritur nga një goditje në zemër të të atit, një avokat i njohur, kishte trashëguar prej tij zyrën e avokatisë me disa punonjës, ku kishte qenë edhe vetë e punësuar pas mbarimit të studimeve.

‘Nga ana ime i shpjegova se kisha studiuar për matematikë dhe punoja si inspektor në të famshmen DPKR. Banoja edhe unë më vete, në një apartament, që shpresoja ta përdorja edhe si studio, kur të realizoja ëndrrën time për t’u bërë detektiv privat. Sigurisht, nuk e pashë të arsyeshme t’ia tregoja këtë ëndërr, s’do të kishte pikë kuptimi.

‘Para se të zbriste nga makina, ajo më bëri një ftesë.

‘Nëse nuk ke ndonjë plan tjetër, ngjitemi për një kafe tek unë.’

‘Desha të formuloja diçka si ‘çdo plan tjetër tani do ta shumëzoja me zero’. Kjo m’u duk një deklaratë e fryrë. Njëherazi ia dola të hiqja dorë nga një yshtje për ta tërhequr drejt vetes, t’i jepja një të puthur. Arrita vetëm të mërmërisja mbyturazi formulën e shpërlarë ‘do të ishte kënaqësi për mua’. Atëherë ajo

ngriti jakën e palltos, doli jashtë dhe pak minuta më vonë u gjendëm para derës së apartamentit të saj.

“Mjedisi i brendshëm ishte i ngrohtë. Një kondicioner në holl, pranë derës së një ballkoni që shihte nga rruga, ishte i ndezur dhe unë mendova se ndoshta ajo e kishte lënë të ndezur tërë kohën. Si të ma kishte lexuar mendimin, Genta vërejt:

‘Deri para pak minutash, këtu ka qenë njëra nga motrat e mia, studente...’

‘Pse, - gjeta rastin ta pyesja, - sa motra ke?’

‘Kam dy motra, - sqaroi, - njëra, nja dy vjet më e madhe se unë, është e martuar. Tjetra, ajo që ka qenë këtu dhe banon me nënën, është nja tre vjet më e vogël se unë. Po ti, - deshi të mësonte, - ke motra e vëllezër të tjerë?’

‘Jo, - iu përgjigja, - jam fëmijë i vetëm.’

‘Aha’, ia bëri ajo, pa ndonjë koment.

‘Po rrinim ende në këmbë në sallon. Ajo më kërkoi të hiqja xhupin, vajti dhe e vari te një mbajtëse rrobash aty pranë dhe më ftoi të zija vend në një nga kolltukët e mjedisit të ndenjjes, pranë një tryeze të ulët.

‘Të lutem më prit vetëm pak minuta’, tha pastaj dhe se ku vajti. Si më paralajmëroi, u vonua vetëm pak minuta.

‘Po të duash, mund të shkosh në banjë, - m’u drejtua kur u kthye, - ndodhet në fund të hollit.’

‘E falënderova, vajta në banjë. Më tej, ajo po më priste e ulur në njërin nga kolltukët pranë tryezës, mbi të cilën kishte vendosur një shishe me uiski dhe dy gota.

‘Më duket sikur jam në ëndërr’, i thashë.

‘Edhe mua po ashtu’, ma ktheu, duke mbushur me uiski të dyja gotat.

‘A i beson ndonjë providence?’, e pyeta.

‘Doemos, - m’u përgjigj, - ndryshe sonte nuk do të takohesha me ty.’

‘Atëherë e afrova nga vetja.

‘Të lutem, - i mërmërita, - e lëmë uiskin, unë...’

‘Ajo s’më la ta çoja mendimin deri në fund. U ngrit, më zuri nga dora dhe më tërhoqi drejt dhomës së saj të gjumit. Pranë një krevati dopio u zhveshëm secili për hesap të vet dhe bëmë dashuri. Ndaj të gdhirë ajo u ndie e rraskapitur.

‘Mjaft tani’, më tha.

‘Dhe shtoi:

‘Më doli pija fare...’.

‘Të nesërmen, kur hapa sytë, vura re se Genta vazhdonte të flinte. Mora te komodina pranë kokës së krevatit, ku e kisha lënë, orën time të dorës: akrepat tregonin trembëdhjetë e njëzet minuta. Qëndrova në heshtje, pa lëvizur pranë trupit të saj të ngrohtë, krejt të zhveshur, derisa më në fund, afër orës katërbëdhjetë, edhe asaj i doli gjumi.

‘Me të hapur sytë, duke sajuar një buzëqeshje, ajo u shtrëngua pas meje. Shtriu dorën drejt fytyrës sime, më preku buzët. Pastaj e shëtiti pëllëmbën ngadalë mbi gjoksin tim, deri poshtë, më zuri penisin dhe më kërkoi të bënim seks.

“E vura poshtë, u zhyta tek ajo. Genta e lëshoi veten në duart e mia. Kur mbërriti në orgazëm rënkoj, ma mbërtheu kokën me të dyja duart dhe unë pata përshtypjen se do të ulërinte nga vuajtja, aq të rënda u bënë rënkimet e saj. Ajo nuk ulëriu. Thjesht më mbajti të mbërthyer derisa më kafshoi veshin dhe më shtyu.

‘Mjaft’, më tha.

“U çlirua nga unë, e zhveshur siç ishte doli nga dhoma, ndërsa unë mbeta ende i shtrirë në krevat, në pritje të saj. Ajo po vonohej ca si shumë dhe e mora me mend, ishte duke bërë banjë. Vërtet, kur u kthye, mbante të hedhur krahëve një pelerinë-peshqir dhe më tha se po të dëshiroja, edhe unë mund të shkoja të bëja banjë.

“Sigurisht, dëshiroja. U ngrita, dola nga dhoma dhe vajta në banjë. Atje u vështrova në pasqyrë. Do të kisha dashur të rruhesha. Bezdia më e madhe për mua ka qenë gjithmonë të mos rruhesha në mëngjes dhe, pa vetëdije, tek shihesha në pasqyrë, kërkova se mos më zinin sytë ndonjë makinë rroje. Sytë nuk më zunë ndonjë makinë rroje dhe u nguta të bëja banjë. Meqë aty nuk kishte ndonjë pelerinë tjetër, u mjaftova të fshihesha me një peshqir e kështu u ktheva në dhomë.

‘Po më grin uria’, më tha Genta.

“Po rrinim në mjedisin e hollit, unë duke gjerbur një çaj, që ma kishte përgatitur ajo, Genta me një gotë uiski. Për të nxjerrë plumbin e një nate më parë, më tha, kur vuri re se unë u habita që me të hapur sytë, ndonëse ora tashmë ishte plot pesë pasdite, pas një nate të mbingarkuar me pije, ajo ndiente sërish